
Bashkimi Energjetik Kosovë-Shqipëri - Sfidat dhe Mundësitë për të Ardhmen

ANALIZË E POLITIKAVE

09/2021



Autor:	Dardan Abazi Liron Gjocaj
Editor:	Burim Ejupi
Programi:	Zhvillim i qëndrueshëm
Publikimi:	Nëntor 2021
Foto e ballinës:	Pexels



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



**Rockefeller
Brothers
Fund**

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondacionit të Vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

Përmbajtja

Hyrje	3
Metodologjia	4
1. Baza Ligjore dhe Institucionale	4
1.1. Kuadri ligjor.....	4
1.2. Kuadri institucional.....	6
2. Hapat drejt bashkimit.....	8
2.1. Zona Energjetike dhe Blloku Energjetik	9
2.2. Tregu i përbashkët energjetik	10
2.3. Bursa e përbashkët Kosovë-Shqipëri	11
3. Përfitimet nga Integrimi Energjetik	11
3.1. Prodhimi.....	11
3.2. Siguria Energjetike	12
3.3. Penetrimi i Burimeve të Ripërtrishme dhe Integrimi i Tregjeve të Energjisë	13
4. Tregu Nordik i Energjisë.....	14
Përfundime.....	16
Rekomandime.....	18

Hyrje

Bashkimi energjetik Kosovë-Shqipëri është politikë që jo vetëm sjell përfitime socio-ekonomike, por edhe afron të dy vendet në rrugën e integritit evropian. Marrë shembull praktikat e mëhershme të shteteve anëtare të BE-së, është e dëshmuar se tregjet e tilla të përbashkëta kanë benefite shumë më të mëdha në krahasim me tregjet vetanake. Benefitet që sjell operimi energjetik përmes tregut të përbashkët mundësojnë zhvillimin e mëtutjeshëm energjetik dhe ekonomik të vendeve pjesëmarrëse.

Bashkimi i tregjeve të energjisë ofron potencial shumë të mirë edhe për sigurimin e furnizimit me energji, por edhe për uljen e nevojës për prodhim të energjisë. Në tregje më të mëdha, tregtimi i energjisë bëhet më efikas, duke rritur kështu shpejtësinë e përgjigjes kërkesë-ofertë, duke bërë që të rritet siguria e energjisë. Për më tepër, duke u rritur efikasiteti i përgjigjes kërkesë-ofertë ulet edhe nevoja për kapacitete të prodhimit, ngase sasia e kapacitetit rezervë që nevojitet të prodhohet ulet.

Tregu i tillë i përbashkët ka për synim lehtësimin e punës të të dyja sistemeve elektroenergetike të dy shteteve, pra Kosovës dhe Shqipërisë, si nga aspekti teknik ashtu edhe nga aspekti ekonomik.¹ Ky bashkim do të mundëson operim më të lehtë të dyja sistemeve, do të kontribuon në reduktimin e shpenzimeve dhe do të ndihmon në shkëmbimin më të lehtë të rezervave ndërmjet të dy vendeve fqinje të Ballkanit Juglindor. Ndër të tjera, bashkimi energjetik sjell mundësi më të zgjeruara për burimet e ripërtrishme, si dhe lehtëson rrugën drejt arritjes së plotësimin të standardeve europiane.

Kosova dhe Shqipëria me bashkimin e tregjeve të energjisë realizojnë një ndër shtyllat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore dhe një vlerë evropiane. Qëllimi i këtij traktati është të krijojë një hapësirë të vetme rregullative për tregtim, të liberalizoj tregjet energjetike, të përmirësojë sigurinë e furnizimit, të mbrojë ambientin etj.² Me themelimin e Bllokut AK, do të fillon bashkëpunimi i shkëmbimit të rezervave në kuadër të dy tregjeve energjetike Kosovë-Shqipëri me synimin e vazhdueshëm për themelimin e Bursës së përbashkët të energjisë (ALPEX) në kuadër të së cilës do të mundësohet që edhe palët e tjera tregtare të bëhen pjesë e kësaj burse.

Pas një pune disa vjeçare dhe një bashkëpunimi mes Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë OST, në dhjetor të vitit 2019, u nënshkrua marrëveshja për themelimin e Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri ndryshe e njohur edhe si Blloku AK. Një hap i tillë nënkupton avansimin e bashkëpunimit mes të dy vendeve. Bashkëpunimi mes Kosovës dhe Shqipërisë bëhet edhe më ideal duke e ditur që të dyja vendet kanë burime të ndryshme energjetike dhe operojnë me kapacitete të ndryshme.

Ky punim shtjellon rastin e bashkimit energjetik Kosovë-Shqipëri, përfitimet, sfidat dhe hapat që duhen ndjekur për këtë proces. Punimi është ndarë në tre pjesë kryesore. Në pjesën e parë të punimit ne kemi shtjelluar bazën ligjore dhe institucionale, ku me theks të veçantë kemi trajtuar Traktatin e Komunitetit të Energjisë, Direktivat Evropiane dhe legjislacionin vendor. Në fund,

¹ KOSTT (2020), Komunikata për medie me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes Historike për themelimin e Bllokut Rregullues të Sistemeve Energjetike Kosovë-Shqipëri (Blloku AK) e qasshme në <https://www.kostt.com/News/New/2> (qasur në prill, 2021)

² Traktati i Komunitetit të Energjisë, (2005), Traktati për Themelimin e Komunitetit të Energjisë, Preambula, faqe 3, i qasshëm në <https://ec.europa.eu/transparency/regdoc/rep/1/2005/EN/1-2005-435-EN-F1-1.Pdf> (qasur në prill, 2021)

janë dhënë përfundimet dhe rekomandimet e punimit të cilat i janë adresuar institucioneve relevante.

Metodologjia

Metodologjia për hartimin e këtij punimi ka qenë e përzier, kuantitative dhe kualitative. Në pjesën e hulumtimit kuantitativ, ne kemi marrë të dhënat e Zyrës së Rregullatorit për Energji, Operatorit të Sistemit të Transmisionit KOSTT, si dhe Ministrisë së Ekonomisë. Të dhënat kuantitative janë plotësuar nga ato kualitative të cilat janë mbledhur duke përdorur metodën e intervistave gjysmë të strukturuar.

Mbledhja e të dhënave në pjesën e hulumtimit kuantitativ është bërë me metodën e hulumtimit në tavolinë. Ne kemi bërë pastaj analizën e përmbajtjes së të dhënave dhe informatave të marra nga raportet e ndryshme, legjislacioni në fuqi dhe rregulloret e ndryshme. Këto të dhëna ne i kemi kategorizuar në disa kategori të analizës dhe i kemi analizuar për të nxjerrë përfundimet.

Në pjesën e hulumtimit kuantitativ ne kemi zhvilluar intervista me:

1. z. Kadri Kadriu dhe z. Skënder Gjonbalaj nga KOSTT, me datën 6 Prill 2021
2. z. Sabit Gashi dhe z. Skënder Xani nga Ministria e Ekonomisë, me datën 16 Prill 2021
3. z. Petrit Pepaj dhe z. Astrit Saraçini nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datën 22 Prill 2021

Përgjigjet nga intervistat janë sistemuar në një dokument në excel ku janë analizuar përgjigjet e secilit akter duke identifikuar trende dhe përgjigje të shpeshta nëpër kategori të ndryshme si sfida apo mundësi. Në fund, raporti i hulumtimit është shkruar duke marrë parasysh rregullat e shkrimit akademik. Përveç analizës së përmbajtjes, është zhvilluar edhe një analizë kontekstuale para hartimit të përfundimeve dhe rekomandimeve të punimit.

1. Baza Ligjore dhe Institucionale

1.1. Kuadri ligjor

Baza kryesore ligjore, përfshirë Traktatin e Komunitetit të Energjisë, Marrëveshjet KOSTT-ENTSO-e dhe KOSTT-OST, Kushtetutat e Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe Strategjitë e Energjisë, favorizojnë bashkimin energjetik Kosovë-Shqipëri. Duke pasur përkrahje ligjore dhe dakordime mes shteteve fqinje, pra Kosovës dhe Shqipërisë, atëherë përmbushja e projektit të bashkimit të tregjeve energjetike ka filluar. Ky objektivi përfaqëson interesat e të dyja vendeve dhe siguron furnizim më të sigurt për të gjithë konsumatorët. Marrë parasysh se edhe Kosova edhe Shqipëria janë vende në zhvillim dhe që synojnë integrimin evropian, kjo shihet si një hap para drejt avansimit të dyja vendeve ballkanike. Në vazhdim do të shtjellohen të gjitha pikat të cilat kanë ndihmuar dhe do të ndihmojnë në përmbushjen e këtij objektivi energjetik.

Me nënshkrimin e marrëveshjes mes KOSTT dhe ENTSO-e, më 30 qershor 2020, është hapur rruga drejt bashkimit energjetik Kosovë-Shqipëri, apo thënë ndryshe krijimin e Bllokut AK. Marrëveshja mes KOSTT-it dhe OST-it paraqet një tjetër arritje të madhe të dy vendeve fqinje sa i përket fushës së energjisë. Këto dy marrëveshje lehtësojnë arritjen e objektivit të krijimit të tregut të përbashkët energjetik. Nënshkrimi i marrëveshjeve të tilla konfirmon synimin e të dyja vendeve në përmbushjen e obligimeve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Objektivi i kësaj marrëveshje është themelimi i Bllokut të Kontrollit LFC Kosovë-Shqipëri dhe mekanizmit adekuat që do të

mundësojë operimin eficient të sistemeve elektroenergjetike të Kosovës dhe Shqipërisë dhe rrjedhimisht të bllokut LFC AK.³ Kjo marrëveshje përmbush një nga hapat më të rëndësishëm që shtyejnë drejt integritit të tregut energjetik rajonal.

Një ndër shtyllat kryesore mbi idealet e së cilës është ndërtuar Komuniteti i Energjisë është integrimi i tregut rajonal. Komuniteti i Energjisë është krijuar me arsye të qarta, ku ndër të tjera është edhe liberalizimi i tregjeve dhe integrimi i tyre në një treg të vetëm. Integrimi i tregjeve në një të vetëm paraqet përparësi të mëdha në funksionimin adekuat të të gjitha palëve pjesëmarrëse. Traktati i Komunitetit të Energjisë thekson qartë se: “Qëllimet kryesore janë të ndërtojë një kornizë stabile dhe rregullative të tregut, të aftë për tërheqjen e investimeve, të krijojë një hapësirë të vetme rregullative për tregtim, të përmirësojë sigurinë e furnizimit, të përmirësojë gjendjen e mjedisit, dhe të zhvillojë tregun e energjisë dhe të gazit në një rajon më të gjerë gjeografik”.⁴ Por për arritjen e këtyre synimeve që i ka Traktati i Komunitetit të Energjisë, fillimisht duhet të shikohen bazat ligjore, kushtetutat dhe strategjitë që i kanë shtetet që kanë objektiv integrimin e përbashkët të tregjeve.

Kushtetutat e të dy vendeve, Kosovës dhe Shqipërisë, përkrahin bashkëpunimin rajonal dhe kanë një traditë të dakordimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në mes veti. Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026 përcakton integrimin rajonal si një objektiv të qartë të Republikës së Kosovës. Objektiva 2 e Strategjisë thekson që Kosova është plotësisht e përkushtuar për integrimin rajonal:

Qeveria e Republikës së Kosovës është e angazhuar në zbatimin e të gjitha obligimeve të Traktatit për Themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) dhe MSA-së, për krijimin e tregut të lirë dhe konkurrues të energjisë. Qeveria e ka vendosur si prioritet krijimin e një zone të përbashkët tregtare energjetike Kosovë-Shqipëri, si hap të parë drejt integritit në tregun rajonal të energjisë.⁵

Objektivi për krijimin e një zone të përbashkët tregtare energjetike Kosovë-Shqipëri është theksuar drejtpërdrejtë në këtë Strategji. Për më tepër, në kuadër të objektivës 2 të Strategjisë, janë listuar sfidat që Kosova duhet t'i tejkaloj në mënyrë që të arrihet objektivi për integrimin e tregut energjetik. Thuhet se sfidat e njejta i adreson edhe Strategjia Kombëtare e Shqipërisë për vitet 2018-2030.

Kuadri strategjik në Shqipëri, gjithashtu ka ndër objektivat kryesore integrimin rajonal. Skenari i integritit elektroenergjetik Shqipëri-Kosovë, vlerëson qartë se përfitimet janë aq të mëdha sa që integrimi i tregjeve përpos dëshirës, bëhet edhe një synim i domosdoshëm. Ndër të tjera, Strategjia Kombëtare e Energjisë për vitet 2018-2030 thekson se arritja e një synimi të tillë zvogëlon nevojën për import të energjisë dhe rrit të hyrat nga shitja e energjisë, e cila nuk konsumohet. Republika e Shqipërisë njejtë si Republika e Kosovës, është shumë e përkushtuar për arritjen sa më të shpejtë të një tregu të përbashkët KS-AL.

Kosova dhe Shqipëria kanë karakteristikat e veta sa i përket tregjeve përkatëse energjetike, e të cilat do t'i kontribuonin shumë njëra tjetrës. Bashkëpunimi mes të dyja shteteve, siç ka ndodhur deri më sot në shumë fusha, duhet të ndodh edhe në integrimin e tregjeve energjetike. Kjo do të

³ Marrëveshja për themelimin e Bllokut LFC AK, Lënda (Fushëveprimi) e marrëveshjes, faqe 4, (qasur në prill, 2021)

⁴Traktati i Komunitetit të Energjisë, faqe 4, e qasshme në <http://www.ero-ks.org/ERO%20Presentation/ERO%20Presentation%202006/Presentation%20in%20ERE%20Albania/Presentation%20in%20ERE%20Albania%20Nysret%20Avdiu%20alb.pdf> (qasur në prill, 2021)

⁵ Republika e Kosovës, (2018), Strategjia e Energjisë së Republikës së Kosovës 2017-2026, Objektivi 2 – Integrimi në Tregun Rajonal të Energjisë, faqe, 14, e qasshme në http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_e_energji_2017-26_.pdf (qasur në prill, 2021)

ndihmonte në zhvillimin ekonomik, zhvillimin energjetik, si dhe në përbashkjen e kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Bashkimi i tregjeve energjetike do të ndihmonte edhe në integrimin evropian të të dyja vendeve dhe do të lehtësonte punën e të dy operatorëve të transmisionit. Potenciali i të dyja shteteve dhe zbrazësitë që i kanë sistemet përkatëse energjetike, janë indikatorë se integrimi në një treg të përbashkët do të ishte një zgjidhje adekuatë.

1.2. Kuadri institucional

Akterët kryesorë, të cilët marrin pjesë në vendimmarrje dhe zbatojnë politikat përkatëse energjetike të të dyja shteteve, janë Ministria e Ekonomisë së Kosovës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës (ZRRE) dhe Enti Rregullator i Energjisë së Shqipërisë (ERE). Këto janë pjesë përbërëse e institucioneve shtetërore dhe kanë rol kyç në zbatimin e rregulloreve energjetike, krijimin e legjislacionit të ri që lidhet me tregun energjetik dhe hartimin e strategjive energjetike për të dy shtetet. Secila prej tyre ka rëndësi të madhe për mbarëvajtjen e tregut të energjisë në Kosovë dhe Shqipëri. Ndërsa për pjesën e transmisionit dhe distribuimit, operojnë kompani tjera të cilat janë shtetërore dhe private.

Tregun energjetik e përbëjnë edhe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) që kanë rol në sektorin e transmisionit të energjisë, ndërsa Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) kanë rol në distribuicionin e energjisë. Pjesëmarrësit e lartpërmendur të tregut energjetik kanë përgjegjësi të mëdha në plotësimin e kërkesave të konsumatorëve, lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe krijimin e interkoneksioneve të reja. Në pjesët në vazhdim do të shpjegohen më hollësisht të gjitha rolet dhe përgjegjësitë e secilit prej akterëve të sektorit energjetik në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipërisë.

Ministria e Ekonomisë në Kosovë është organi qeveritar që ka në fushëveprimtarinë e saj hartimin e politikave në fushën e energjisë. Në të kaluarën, Kosova ka pasur Ministri të ndarë për Energji dhe Miniera, por tani fusha e energjisë kryesisht i mveshet Ministrisë së Ekonomisë. Kjo Ministri pra, harton Strategjinë e Energjisë si dokumentin kryesor strategjik, sponzoron ligje dhe ndërmerr vendimet kryesore strategjike sa i takon fushës së energjisë. Megjithatë, Ministria e Energjisë është vetëm organi politik, në një mjedis të pasur institucionesh e akterësh.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë është organ i pavarur, i cili ka për detyrë të rregullojë aktivitetet në Sektorin e Energjisë në Kosovë, përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen qëndrore dhe gazin, në pajtim me detyrimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe legjislacioni vendor.⁶ ZRRE ka mundësinë që të jap licensa dhe të shikojë nëse ato licensa respektohen nga kompanitë, të miratoj tarifat e aktiviteteve të shërbimeve publike, dhe të punoj në hartimin e legjislacionit sekondar për sektorin e energjisë. ZRRE është përgjegjëse edhe për formulimin e kornizës rregullative, duke u bazuar në parimet e tregut të lirë. ZRRE gjithashtu ka kompetencat për të caktuar paraprakisht metodat e vënies së çmimit dhe më vonë për të miratuar tarifat për shërbimet e rregulluara të energjisë. ZRRE në kompetencat e veta ka edhe monitorimin e kompanive të transmisionit, distribuicionit dhe furnizimit të energjisë elektrike në vendin tonë.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është organi kompetent për hartimin e politikave të energjisë në Republikën e Shqipërisë. Ajo bënë hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme

⁶ ZRRE, Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë, Për Ne, e qasshme në <https://ero-ks.org/zrre/per-ne>, (qasur në prill, 2021)

shtetërore, në sektorin e planifikimit dhe zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës dhe transportit, në sektorin e telekomunikacionit e shërbimit postar, në sektorin e energjisë, shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare dhe në sektorin e industrisë.⁷ Hartimi i strategjive energjetike është njëra nga përgjegjësitë e tjera të kësaj ministrie. Po ashtu, modeli i tregut energjetik që është hartuar më parë, është në kompetencat e ministrisë në fjalë dhe ndarja e përgjegjësisë tek akterët e tregut energjetik bëhet nga kjo ministri. Për përmbushjen e këtyre synimeve që ka Qeveria e Republikës së Shqipërisë, ndihmë të madhe ofron edhe Enti Rregullator i Energjisë së Shqipërisë.

Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE) është person juridik publik, i pavarur nga interesat e industrisë së energjisë dhe nga organet shtetërore. ERE është krijuar në vitin 1995 dhe aktualisht funksionon në bazë të ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe ligjit nr.102/2015 "Për sektorin e gazit natyror".⁸ Enti Rregullator i Energjisë ka detyrë që të siguroj furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike për konsumatorët e vet, duke mundësuar një treg konkurues dhe që funksionon në të mirë të konsumatorit dhe të mjedisit. Ky organ energjetik ka në përgjegjësi edhe licensimin dhe autorizimin e të gjitha proceseve që kanë të bëjnë me tregun energjetik në Republikën e Shqipërisë. Pra, ERE paraqet një pjesëmarrës shumë të rëndësishëm në fushën energjetike, pasi që gjitha këto përgjegjësi që ka ndihmojnë edhe në integrimin rajonal dhe evropian të tregjeve energjetike.

KOSTT sh.a. është Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, kompani publike me 100% të aksioneve shtetërore.⁹ KOSTT është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregut të energjisë elektrike në Republikën e Kosovës. Ky administrim bëhet duke transmetuar energjinë elektrike nga pjesa e gjenerimit e deri tek njësia e shpërndarjes. KOSTT është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe operimin e linjave të tensionit të lartë, pra 400 kV, 220 kV dhe 110 kV. Në vitin 2020, KOSTT-i u anëtarësua në ENTSO-e (European Network of Transmission System Operators for Electricity)¹⁰, process ky i cili mundëson që Kosova të bëhet zonë rregullative e pavarur. KOSTT-i është organ shtetëror, i cili operon në bazë të standardeve evropiane dhe synim i saj është punimi dhe implementimi i projekteve të reja kapitale me të cilat do të përfitonte vendi dhe regjioni.

Sistemi i transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a), një shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore. OST kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Sistemit të Dispečimit dhe Operatorit të tregut.¹¹ OST është përgjegjëse për transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar brenda vendit, krijimin e rrugës drejt integritetit regjional të tregjeve elektrike, si dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit në përputhje me kërkesat e konsumatorëve. OST merret me krijimin e kushteve afatgjate, të cilat sigurojnë furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike për konsumatorët e Republikës së Shqipërisë, krijimin e interkoneksioneve të reja me vendet fqinje dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të rrjetit publik energjetik.

⁷ Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë, e qasshme në <https://www.infrastruktura.gov.al/misioni-2/>, (qasur në prill, 2021)

⁸ Enti Rregullator i Energjisë, e qasshme në <https://www.ere.gov.al/mat.php?idr=178&idm=155&lang=1>, (qasur në prill,2021)

⁹ KOSTT, Profili i Kompanisë, e qasshme në <https://www.kostt.com/Home/About>, (qasur në prill, 2021)

¹⁰ ENTSO-e, e qasshme në <https://www.entsoe.eu/>, (qasur në prill,2021)

¹¹ OST, e qasshme në <https://www.infrastruktura.gov.al/ost-2/>, (qasur në prill, 2021)

Distribucioni në Kosovë drejtohet nga Kompania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë sh.a. (KEDS) e cila është pronë e kompanive turke, Çalik Holding dhe Limak.¹² Kjo kompani është e licensuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, dhe ka detyrën e shpërndarjes së energjisë elektrike, në territorin e Republikës së Kosovës. Rrjeti i shpërndarjes përbëhet nga linjat e tensionit 35 kV, 10(20) kV, 6 kV dhe 0.4 kV. Distribuimi është njëri nga faktorët kryesor në tregun energjetik në çdo vend të botës. KEDS-i ka rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të rrjetit energjetik, plotësimin e kërkesave të klientëve, si dhe mirëmbajtjen dhe investimet e vazhdueshme në rrjetin energjetik të Republikës së Kosovës.

Distribucioni në Shqipëri është nën përgjegjësinë e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.A. (OSHEE) që është person juridik, i cili funksionon si shoqëri aksionare, organizimi i së cilës bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, date 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar). Kjo kompani është përgjegjëse për ofrimin e energjisë elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes, zhvillimin e rrjetit energjetik dhe të ofrojë shërbime shtesë për të gjithë konsumatorët, sipas nevojës.¹³ Përgjegjësi e OSHEE-së është që të përmirësojë cilësinë e furnizimit me energji elektrike, duke investuar në rrjetin aktual energjetik, dhe duke bashkëpunuar me kompanitë tjera rajonale, të cilat kryejnë funksionin e njejtë. OSHEE duhet të sigurohet që të gjithë qytetarët të kenë qasje në energji elektrike, dhe të mundohet që të përmbushë çdo kërkesë që ndihmon në krijimin e një tregu energjetik me standarde evropiane.

2. Hapat drejt bashkimit

Kosova burim kryesor të energjisë e ka linjtitin. 86.49% e kapacitetit operativ të energjisë elektrike totale gjenerohet nga ky burim, ndërsa pjesa tjetër nga hidrocentralet, centralet me erë dhe centralet solare. Basenet kryesore të linjtitit janë: Baseni i Kosovës, Baseni i Dukagjinit dhe Baseni i Drenicës.¹⁴ Si lëndë djegëse, ndotja që i shkaktohet mjedisit me djegien e tij, është shumë e madhe dhe shumë e dëmshme për të gjithë organizmat e gjallë. Viteve të fundit ka filluar edhe inkuadrimi i burimeve të ripërtrishme të energjisë në tregun energjetik tonin, por ende nuk janë arritur caqet e synuara.

Kosova nuk ka gjenerim aq sa ka kërkesë të energjisë nga konsumatorët. Pasi që gjenerimi bëhet nga termocentralet dhe kapaciteti gjenerues i tyre nuk është adekuat me aq sa nevojitet, viteve të fundit në treg janë integruar edhe BRE-të. Sipas ASK-së dhe ZRRE-së, konsiderohet se nën 15% e totalit të energjisë në vendin tonë, është e prodhuar nga këto burime. Duke e pasur kështu të domosdoshme importimin e energjisë elektrike nga vendet tjera, Kosova ka qenë e detyruar të importojë edhe nga Serbia, si prodhuesi më i madh i energjisë në rajon. Ky import ka qenë i detyruar, për arsye të përmbushjes së kërkesave për energji elektrike, dhe si rrjedhojë importi nga Serbia ka paraqitur probleme dhe vështirësi për sistemin energjetik të Kosovës. Por, problem tjetër edhe më i madh i sistemit energjetik të Kosovës ka qenë edhe identifikimi nga shtetet tjera si territor i brendshëm energjetik i Serbisë.

Edhe pse si shtet është i pavarur që nga viti 2008, në aspektin energjetik Kosova është konsideruar si territor i brendshëm i Serbisë deri në vitin 2020. Deri në këtë vit, Kosova ka hasur në telashe të

¹² KEDS, Rreth Nesh, Profili i KEDS, e qasshme në <https://www.keds-energy.com/shq/rrreth-nesh/profili-i-keds/>, (qasur në prill, 2021)

¹³ OSHEE, Cilet Jemi, e qasshme në <https://oshee.al/cilet-jemi/>, (qasur në prill, 2021)

¹⁴ Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Vendburimet minerale, e qasshme në <https://kosovo-mining.org/resurset-minerale/vendburimet-minerale/>, (qasur në prill, 2021)

mëdha në shumë aspekte të sektorit energjetik. Importi dhe rrugët e bllokuara të autostradave energjetike, kostot financiare, mosfunksionimi i linjës interkonektive 400kV me Shqipërinë, kanë qenë disa nga problemet kryesore që ne si vend kemi hasur gjatë kohës sa konsideroheshim pjesë e brendshme e territorit të Serbisë. Me arritjen e pavarësimit energjetik të Kosovës dhe njohjen e saj si zonë e pavarur energjetike, problemet e cekura më lartë filluan të mos paraqiten.

Me datë 20 prill 2020 u votua nga Grupi Regjional i Evropës Kontinentale (RGCE), Marrëveshja e re për kyçjen mes KOSTT-it dhe ENTSO-E.¹⁵ Deri në prill të vitit 2020, Kosova ka qenë pjesë e Bllokut rregullues SMM (Serbi, Mali i Zi, Maqedoni Veriore). Sipas kësaj marrëveshjeje, Kosova largohet përfundimisht nga Blloku rregullues SMM, dhe njihej si territor energjetik i pavarur. Kosova i bashkohet tashmë Bllokut rregullues me Shqipërinë, që ndryshe njihet edhe si Blloku AK (Albania-Kosovo). Po ashtu, linja interkonektive 400kV, e cila u ndërtua në vitin 2016 dhe e cila nuk lejohej nga Serbia që të funksionalizohej, tashmë e ka të mundur operimin pa asnjë problem. Kosova dhe Shqipëria si dy zona energjetike të veçanta, e kanë të hapur tashmë rrugën drejt themelimit të Tregut të përbashkët elektroenergjetik dhe një gjë e tillë pritet shpejtë të konkretizohet.

2.1. Zona Energjetike dhe Blloku Energjetik

Zona Energjetike paraqet territorin e pavarur elektroenergjetik që përcaktohet fizikisht nga pikat e matjes së interkonektorëve me territoret tjera energjetike. Si Kosova, ashtu edhe Shqipëria operojnë si zona energjetike të pavarura. Si zona të veçanta energjetike të dyja kanë mundësi që të zhvillohen dhe t'i avansojnë tutje teknologjitë prodhuese të tyre. Operimi si zona energjetike të ndara, paraqet më shumë sfida dhe krijon kufizime sa i përket rezervave, alokimit të kapaciteteve, krijimit e likuiditetit të tregut etj. Por si zona të pavarura energjetike, ekzistojnë normalisht edhe avantazhet të cilat sigurojnë një treg me rrjedhshmëri në të mirë të konsumatorit.

Si zona të pavarura energjetike, të dyja shtetet pra, edhe Kosova, edhe Shqipëria kanë mundësinë e kontrollimit të kapaciteteve në kufi, leximin e matjeve, pregaditjen e tregut, por edhe arritjen e marrëveshjeve të cilat bashkojnë zonat energjetike me njëra tjetrën.¹⁶ Tregtimi bëhet kufi për kufi dhe duke e pasur të ditur se sa kapacitete të lira ndodhen, atëherë mund të caktohet edhe sasia e tregtimit që do të bëhet. Ndërsa leximi i matjeve si përgjegjësi e zonave të pavarura energjetike, bëhet nga kompanitë e transmisionit dhe paraqet matje të sakta të secilit parametër që lidhet me sistemin elektroenergjetik, ndërsa këto matje ndihmojnë edhe në pregaditjen e tregut dhe rrjedhshmërinë e tij. Këto janë vetëm disa parametra të cilat tregojnë përparësitë e zonave të pavarura energjetike, ndërsa sinkronizimi i këtyre zonave do të zhvillonte tutje të dyja vendet.

Sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe Strategjive të të dyja vendeve, zonat energjetike duhet të bashkohen me njëra tjetrën dhe kështu t'a krijojnë një treg të përbashkët energjetik apo zonë të përbashkët energjetike.¹⁷ Ky komunitet vlerëson se krijimi i një tregu të përbashkët energjetik do të ndihmojë në stabilitetin e tregut dhe sigurinë e tij, do të ngritë investimet dhe do të paraqesë hapësirë më të madhe për burimet e ripërtrishme të energjisë etj. Por, integrimi i tregut të energjisë në koordinim me Shqipërinë është vlerësuar si mundësi shumë e mirë edhe nga ekspertët e fushës së energjisë në Kosovë, të cilat kanë kontribuar në krijimin e bllokut me

¹⁵ KOSTT, Për media, Përmbillet me sukses votimi i Marrëveshjes së re të Kyçjes KOSTT/ENTSO-E, e qasshme në <https://www.kostt.com/News/New/2021>, (qasur në prill, 2021)

¹⁶ Ibid.

¹⁷ EUR-Lex, The Energy Community Treaty, e qasshme në www.shorturl.at/HRY37, (qasur në prill, 2021)

Shqipërinë. Blloku energjetik dhe karakteristikat e tij si trup i përbashkët mes dy zonave energjetike do të zhvillojë Kosovën dhe Shqipërinë gjatë viteve të ardhshme.

Bashkimi i disa zonave energjetike (TSO-ve të pavarura) formon Bllokun Energjetik. Blloku energjetik ka më shumë përparësi se sa operimi vetëm si zonë energjetike, për arsye se kostoja e operimit është më e lirë, siguria energjetike rritet dhe sigurimi i rezervave lehtësohet. Shembulli më i mirë për këtë janë vendet nordike të Europës, të cilat jo vetëm që kanë arritur bashkimin e zonave energjetike dhe krijimin e një tregu të përbashkët, por kanë avansuar shumë përdorimin e burimeve të ripërtrishme të energjisë, si burim primar të tyre. Por nuk do të thotë domosdoshmërisht, që Blloku i përbashkët energjetik të ketë edhe Tregun e përbashkët energjetik.

2.2. Tregu i përbashkët energjetik

Tregu është komponenta e dytë e bashkimit energjetik. Tregu paraqet bashkimin e interkonektorëve dhe më pastaj tregtimin e energjisë përmes tyre. Krijimi i një tregu të përbashkët energjetik është i favorshëm për secilin shtet. Kjo pasi që siguron rrjedhje më të sigurtë të energjisë, alokim më të lehtë të kapaciteteve, tregtim më të shpejtë dhe më të lirë, si dhe siguron çmim më të përballueshëm për konsumatorët. Objektivat e ENTSO-E, Strategjitë e Energjisë, Direktivat e Bashkimit Europian dhe Pakoja e Tretë e Energjisë e përkrahin integrimin e tregjeve në një të vetëm, duke konstatuar se kjo garanton më shumë transparencë dhe likuiditet më të madh si për tregtarët dhe operatorët, ashtu edhe për blerësit. Kosova dhe Shqipëria në të ardhmen e afërt synojnë një treg të përbashkët jo vetëm me njëra tjetrën, por edhe me vendet tjera të Ballkanit, e pse jo edhe me vendet e tjera të Evropës më pastaj.

Kosova dhe Shqipëria në Strategjitë e Energjisë përkatëse synojnë që të arrihet Tregu i përbashkët energjetik. Përpos optimizimit të rezervave, ku kostoja për konsumatorin është me çmim më të përballueshëm, sipas kodeve të ENTSO-E, Kosova dhe Shqipëria mundën edhe t'i tregtojnë rezervat tashmë. Të dyja vendet fqinje e synojnë bashkimin e tregut energjetik, pasi që do të optimizonin rezervat, do të zvogëlonin koston operative, do të arrihej më shpejtë integrimi në BE, si dhe burimet e ripërtrishme të energjisë do të përfitonin më shumë hapësirë në treg. Tregu mes Kosovës dhe Shqipërisë konsiderohet si një treg i sigurt dhe jo treg i cili mund të paraqesë probleme sikur ai me Serbinë. Edhe pse të dyja vendet konsiderohen si shtete të vogla, integrimi i tregut mes Kosovës dhe Shqipërisë po shihet si një opsion që mund t'i zhvillojë treg me llojllojshmëri produktesh.

Zakonisht shtetet e vogla nuk mundën të zhvillojnë tregje adekuate likuide, pasi që nuk kanë kapacitete të ndryshme, por as palë pjesëmarrëse që të krijojnë një llojllojshmëri të tregut.¹⁸ Tregu i përbashkët synon një laramani të produkteve që më pastaj të ekzistojë konkurrenca dhe të ketë mundësi konsumatori që të zgjedh atë që përkon më së miri me interesat e tij. Konkurrenca sjell transparencë më të madhe, mundësi zgjedhjeje, operim më të mirë të tregut, si dhe siguri për furnizim me energji elektrike. Me integrimin tutje të burimeve të ripërtrishme të energjisë, do të krijohej më shumë laramani dhe më shumë opsione për konsumatorët. Pasi që edhe Pakoja e katërt e Energjisë, e miratuar nga BE-ja, ka zgjedhur që të bazohet në energji të pastërt, atëherë edhe ne duhet të përshtatemi me kushtet dhe sygjerimet e BE-së. Bursa Shqiptare e Energjisë do të krijoj më shumë hapësira për burimet e ripërtrishme dhe lehtësim për daljen në treg të tyre.

¹⁸ Ibid.

2.3. Bursa e përbashkët Kosovë-Shqipëri

Në Western Balkan 6 lindi ideja për memorandumun që më pastaj e nënshkruan shtetet e Ballkanit Perëndimor për krijimin e bursave energjetike.¹⁹ Në vitin 2017 u nënshkruan 12 marrëveshje mes Kosovës dhe Shqipërisë, ku krijimi i bursës së përbashkët ishte njëra ndër pikat. Kjo bursë është një model i Sekretariatit të Energjisë. Fillimisht ka qenë nevoja për ndryshimin e ligjeve si dhe rregullave dhe në të njëjtën kohë është marrë edhe vendimi nga Këshilli i Ministrave të Shqipërisë që pjesë e bursës mund të jenë vetëm TSO-të të cilat nuk janë pjesëmarrëse në ndonjë bursë. Vetëm KOSTT-i e përmbushte këtë kriter dhe kështu u hap rruga drejt themelimit të Bursës Shqiptare të Energjisë e cila ende nuk ka filluar operimin. Aksionarë të plotë të bursës janë dy TSO-të përkatëse, pra KOSTT-i dhe OST-i.

KOSTT-i dhe OST-i synojnë krijimin e bursës së përbashkët dhe pastaj integrimin e bursës me vendet tjera të regjionit. Pas bisedimeve dhe konsultimeve edhe mes njëra tjetrës por edhe me akterët e jashtëm evropian, siç është ENTSO-E, u konstatua se Blloku i përbashkët mes Kosovës dhe Shqipërisë mund të funksionojë. Si rrjedhojë me datën 5 Tetor 2020, ish kryeshefi i KOSTT-it, z. Ilir Shala dhe administratori i OST-së, z. Skerdi Drenova, nënshkruan marrëveshjen për themelimin e Bursës Shqiptare energjetike, e njohur me emrin ALPEX.²⁰ Bursa ALPEX, nëse proceset e mbetura rrjedhin sipas planit, pritet të fillojë operimin në pranverën e vitit 2022, saktësisht në mars 2022 dhe synimi i saj përpos funksionimit më eficient dhe krijimit të sigurisë energjetike për të dyja vendet, është edhe bashkimi me bursat tjera regjionale. Sa më i madh blloku dhe tregu, siguria vetëm sa rritet dhe bashkëpunimi lehtësohet, dhe me këtë parim duhet të funksionojë edhe Bursa ALPEX në të ardhmen.

3. Përfitimet nga Integrimi Energjetik

3.1. Prodhimi

Me integrimin e tregjeve të energjisë, nevoja për prodhim të energjisë bie. Me rritjen e tregut të energjisë, fleksibiliteti i tregut rritet duke i ofruar mundësi më shumë prodhuesve që të futen në rrjet. Kjo rritë energjinë që futet në rrjet, duke bërë që prodhuesit të marrin sinjalin se duhet të reduktohet prodhimi.²¹ Sa i përket prodhimit, Kosova dhe Shqipëria dallojnë edhe në sasi edhe në burime.

Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i instaluar në Shqipëri deri në 31 Dhjetor 2019 është 2,275 MW.²² Ky kapacitet ka pasur një nivel rritje në vitin 2019 prej 71MW krahasuar me vitin 2018. Kapaciteti total prodhues i energjisë elektrike i kompanisë publike KESH sh.a. është 1448 MW dhe përbën rreth 63.47% të fuqisë totale të instaluar. Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të tjerë të energjisë elektrike është 827 MW dhe përbën rreth 36.53% të fuqisë totale të instaluar.

¹⁹ Energy Community, Home, News, e qasshme në <https://energy-community.org/news/Energy-Community-News/2018/05/18.html> , (qasur në prill, 2021)

²⁰ KOSTT, Për Media, e qasshme në <https://www.kostt.com/News/New/2> , (qasur në prill, 2021)

²¹ Epexspot, (2021), Basics of the Power Market, Electricity - a unique commodity, What are negative prices and how do they occur, i qasshëm në <https://www.epexspot.com/en/basicspowermarket>, (qasur në maj, 2021)

²² ERE, Raporti Vjetor 2020, e qasshme në <https://ere.gov.al/doc/Raporti%20vjetor%202020.pdf> , (qasur në tetor, 2021)

Prodhimi i gjithmbarshëm i energjisë elektrike në Kosovë për vitin 2020 ka qenë 6,301 GWh, ndërsa në vitin 2019 ka qenë 5,718 GWh, që do të thotë se ka një rritje prej 10.2%.²³ Ndërsa, krahasuar me bilancin e energjisë elektrike për vitin 2020, prodhimi është realizuar rreth 101.4%. Integrimi i mëtutjeshëm i burimeve të ripërtrishme, do të rriste kapacitetin prodhues energjetik, e në të njëjtën kohë do të kontribuonte në zhvillimin e një tregu më të suksesshëm.

3.2. Siguria Energjetike

Siguria energjetike paraqet qasjen në burimet e energjisë elektrike me një qëndrueshmëri të furnizimit dhe çmim të përballeshëm. Siguria energjetike vë në pah atëherë kur ka më së shumti kërkesë për të dhe ajo paraqet bazën e funksionimit të një tregu të mirë energjetik. Sot me avansimin e teknologjisë nevoja për energji elektrike vetëm sa është rritur dhe konsumatorët kërkesën kryesore e kanë që të furnizohen me energji elektrike gjatë gjithë kohës dhe me çmim të përballeshëm. Integrimi i burimeve të ndryshme për gjenerimin e energjisë elektrike do t'i siguronte Kosovës dhe Shqipërisë, furnizim me energji elektrike pa ndërprerje për konsumatorët e tyre.

Kosova energjinë elektrike e siguron kryesisht nga thëngjilli, ndërsa Shqipëria në masë më të madhe nga uji. Kosova ka kapacitete të instaluar prodhuese prej 1442 MW, përfshirë edhe kapacitetet gjeneruese nga BRE, megjithatë kapaciteti operativ konsiderohet rreth 1,110 MW, prej të cilave termocentralet (TC) me linjit përbëjnë rreth 86.49 %, ndërsa pjesa tjetër përbëhet nga BRE-të.²⁴ Shqipëria 2979 GWh ose gati 57 % të të gjithë prodhimit të energjisë elektrike e ka nga centralet në zotërim të KESH-it, ndërsa pjesa tjetër e prodhimit prej 2226 GWh u prodhuan nga centralet e tjera, e cila zë mbi 43%.²⁵ Vetëm 22196 MWh prodhohen nga centralet fotovoltaike, kurse pjesa tjetër nga hidrocentralet. Të dyja shtetet do të arrijnë siguri energjetike më të madhe kur të integrohen totalisht me njëra tjetrën.

Qëndrueshmëria e furnizimit paraqet themelin e sigurisë energjetike. Kjo do të thotë që furnizimi pa reduktime të energjisë elektrike dhe kualiteti i lartë i energjisë duhet të paraqet një standard të secilit vend. Sipas raportit vjetor të ZRRE-së, gjatë vitit 2020 reduktimet e energjisë si pasojë e mungesës së saj kanë qenë 0.²⁶ Siguria energjetike vetëm sa do të rritet me krijimin e bllokut energjetik AK dhe kjo paraqet një tjetër avantazh të integritetit energjetik të të dyja shteteve.

Sa më i madh tregu energjetik, aq më e madhe siguria energjetike dhe aq më i përballeshëm çmimi. Kjo do të thotë se siguria energjetike në një treg të përbashkët do të rritet, për arsye se konkurrenca mundëson që të ketë furnizim adekuat për konsumatorët. Kjo sepse konsumatori gjithmonë do të mundohet që t'i marrë shërbimet e njëjta me çmimin më të lirë në treg.²⁷ Nëse nuk zhvillohet konkurrenca, atëherë çmimi normalisht se do të jetë më i lartë, pasi që shumë pak operatorë ofrojnë energjinë elektrike dhe konsumatori nuk ka mundësi për të zgjedhur. Përpos burimeve energjetike, qëndrueshmërisë së furnizimit dhe tregut të përbashkët energjetik, një tjetër tregues i sigurisë së furnizimit është edhe e ashtu quajtura "Generation Adequacy".

²³ ZRRE, Raporti Vjetor 2020, e qasshme në https://www.ero-ks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Raportet%20Vjetor/Raporti%20vjetor%202020_ZRRE_shqip.pdf, (qasur në tetor, 2021)

²⁴ Raporti Vjetor 2020, ZRRE

²⁵ Raporti Vjetor 2019, ERE, e qasshme në https://ere.gov.al/doc/Raporti_vjetor_2019_perfundimtar.pdf, (qasur në prill, 2021)

²⁶ Raporti Vjetor 2020, ZRRE

²⁷ Intervistë e INDEP me përfaqësues të KOSTT, me datë 6 prill 2021, Prishtinë.

“Generation Adequacy” është indikator që na tregon se sa ne mundemi me e mbulu kërkesën në kohën e pikut. Ky dokument është i rëndësishëm për tregun e energjisë sepse kërkon të demonstron nëse furnizimi me energji elektrike është në gjendje të mbetet i sigurt dhe i disponueshëm kur është nevoja. Nëse ndodh ndonjë dështim i njësisë gjeneruese për shembull, atëherë duhet të përdoren rezervat dhe aty shikohet kapaciteti i tregut energjetik. Zhvillimi i një adekuacie të gjenerimit të përbashkët nga Kosova dhe Shqipëria duhet të jetë një synim në të ardhmen e tregut të përbashkët energjetik.

3.3. Penetrimi i Burimeve të Ripërtrishme dhe Integrimi i Tregjeve të Energjisë

Tregu i përbashkët energjetik do të krijonte mundësi më të mëdha investuese, më shumë hapësirë për burimet e ripërtrishme dhe benefite më të mëdha për konsumatorët. Duke qenë se të dy vendet kanë një përqëndrim të burimeve të ndryshme të energjisë, bashkimi i tregjeve jo vetëm që do të ishte kompatibil, por do të krijonte mundësi edhe për penetrimin më të madh të burimeve të ripërtrishme në përgjithësi. Në të njëjtën kohë, tregu i përbashkët do të lehtësonte fushën e veprimit të operatorëve privat, qoftë prodhues, qoftë furnizues, duke lehtësuar liberalizimin e tregut dhe ulur çmimet në një projeksion afatgjatë. Përfundimisht, tregu i përbashkët ndikon në diversifikimin e burimeve të energjisë në të dy anët e kufirit dhe krijon mjedis më të favorshëm investues për tranzicionin e gjatë energjetik.

Tregu më i gjerë energjetik do të thotë më shumë mundësi për investime. Tregu i ri i përbashkët që po synohet, do të ketë nevojë për investime nga faktorët e brendshëm por pse jo edhe ata të jashtëm. Tregu i cili përmban në vete numër të madh të konsumatorëve, është tërheqës edhe për investitorin, pasi që paraqet më shumë siguri për investim nga ana e tij. Krijimi i një tregu energjetik me shumë investitor, do të shënonte një hap para drejt liberalizimit të plotë të tregut dhe do të ndihmonte zhvillimin e konkurrencës. Njëkohësisht viteve të fundit me favorizimin që po i'u bëhet burimeve të ripërtrishme nga e gjithë bota, mund të krijohen kushte shumë të favorshme për investitorët e huaj që të investojnë në tregun e përbashkët energjetik mes Kosovës dhe Shqipërisë.

Konsumatori përfiton nga përdorimi i burimeve të ripërtrishme të energjisë, sepse çmimi i tyre është më i lirë në një treg më të madh. Teknologjia e gjenerimit nga burimet vetëm sa shkon duke zbritur kur investimet në këtë lami rriten. Tjetër faktor që ndikon në çmim më të lirë janë mos nevojat për transport të lëndës së parë dhe mos nevojat për deponimin e saj. Tek sa teknologjia e tyre vetëm sa po zhvillohet dita ditës, dhe njëkohësisht investitorët vetëm sa po rriten në këto burime, çmimi i tyre detyrimisht do të zvogëlohet. Këto parametra tregojnë që energjia e ripërtërishme nuk është vetëm favorite për mjedisin dhe mbrojtjen e tij, por ka edhe avantazhe në aspektin ekonomik.

Burimet e ripërtrishme të energjisë janë e ardhmja e tregut energjetik. Tregu i përbashkët energjetik Kosovë-Shqipëri krijon mundësi në avansimin e përdorimit më të madh të këtyre burimeve. Tregu i integruar zhvillon hapësira që mund t'a zvogëlojnë çmimin e përdorimit të burimeve të ripërtrishme, pasi që tregu i tillë ka efikasitet më të madh dhe benefite më të mëdha në investim te këto burime. Në tregun e përbashkët, përpos mbrojtjes së mjedisit, që është një nga benefitet kryesore të burimeve të ripërtrishme, aspekti ekonomik është shumë i rëndësishëm. Burimet e ripërtrishme të energjisë janë e ardhmja e sektorit energjetik dhe zvogëlimi dhe dikur eliminimi i prodhimit të energjisë nga burimet fosile do të paraqiste favore, sidomos për Kosovën, e cila bazohet në thëngjill.




Figura 1: Zbirtja e çmimeve të teknologjive të burimeve të ripërtrishme Burimi: Energypost.eu ²⁸

Hidrocentralet, centralet me erë dhe centralet fotovoltaike kontribuojnë në gjenerimin total të energjisë elektrike të Kosovës. Caku sipas Udhëzuesit Administrativ për prodhim të energjisë nga burimet e ripërtrishme të energjisë deri në vitin 2020, ka qenë 25% të konsumit përfundimtar bruto.²⁹ Sipas raportit vjetor të ZRRE-së për vitin 2020, vetëm 13.51% e energjisë elektrike në vendin tonë, gjenerohet nga këto burime. Hidrocentrali i Ujmanit kryeson me 2.91% të gjenerimit total nga BRE-të, ndërsa 2.95% nga centrali me erë “Kitka”. Pjesën tjetër e përbjënë centrali me panele fotovoltaike në Gjakovë, i quajtur Eco Park dhe disa hidrocentrale tjera të vogla. Integrimi i mëtutjeshëm i burimeve të ripërtrishme të energjisë në sistemin tonë energjetik, do të ndihmonte në arritjen e caqeve europiane dhe do të ndihmonte në ristrukturimin e sistemit energjetik.

Për gjenerimin e energjisë elektrike në Shqipëri, kontributin më të madh e japin hidrocentralet. Sipas raportit vjetor të ERE-së, për vitin 2019, 99.9% e energjisë elektrike e gjenerojnë hidrocentralet, ndërsa vetëm 0.004% gjenerohet nga centralet fotovoltaike.³⁰ Shqipëria ka pasur favorizim gjeografik dhe ujëra të mjaftueshëm për shfrytëzimin e tyre që të prodhojë energji elektrike. Energjia e tillë përdoret më lehtë dhe ka vlerë të madhe, pasi që mund të konsiderohet edhe si energji e ruajtur. Hidrocentralet vihen në funksion në shumë pak minuta dhe janë shumë të përshtatshëm për orët e pikut. Shqipëria tashmë i ka përmbushur caqet europiane për gjenerim të energjisë nga burimet e ripërtrishme dhe me krijimin e tregut të përbashkët me Kosovën, vetëm sa do t'i ndihmonte edhe Kosovës që t'i përmbush caqet e veta.

4. Tregu Nordik i Energjisë

Tregu nordik i energjisë elektrike është një treg i përbashkët për vendet skandinave, unik, i cili si burim kryesor të gjenerimit i ka burimet e ripërtrishme të energjisë dhe që përdor mënyra të avansuara të tregtimit të saj. Norvegjia, Suedia, Finlanda dhe Danimarka kanë ndarë prej kohësh një treg të vetëm të energjisë elektrike dhe shërbejnë si një shembull kryesor për vendet e tjera në mbarë botën se si të liberalizojnë tregjet e energjisë elektrike përtej kufijve kombëtarë. Interkonektorët bashkohen mes vete në vendet tokësore dhe ujore, dhe formojnë një treg të përbashkët i cili siguron tregti efikase. Duke shfrytëzuar gjenerim të energjisë elektrike nga burime të renovueshme, tregu nordik ka fituar epitetin e një tregu shembull për vendet e tjera.

²⁸ www.shorturl.at/wKU06, (qasur në prill, 2021)

²⁹ Strategjia e Energjisë e Kosovës 2017-2026

³⁰ Raporti Vjetor 2019, ERE, e qasshme në https://ere.gov.al/doc/Raporti_vjetor_2019_perfundimtar.pdf, (qasur në prill, 2021)




Figura 1. Ndarja regionale e tregjeve të energjisë. Burimi: 9th International Conference on the European Energy Market

Sistemi energjetik nordik është një përzierje e burimeve prej të cilave bëhet gjenerimi, ku energjia hidrike, bërthamore dhe era janë burimet kryesore. Vendet nordike kanë një pjesë më të lartë të prodhimit të energjisë së rinovueshme, krahasuar me pjesën tjetër të BE, ku mbi gjysma e prodhimit të energjisë elektrike në këtë treg gjenerohet nga hidrocentralet.³¹ Shfrytëzimin në masë të madhe të burimeve të ripërtrishme të energjisë e ka mundësuar favorizimi gjeografik që e kanë vendet e rajonit skandinav. Zhvillimi i konsumit të energjisë elektrike ndikohet shumë nga moti gjatë vitit, me kërkesë më të ulët të energjisë elektrike gjatë verës dhe rritje të konsumit gjatë dimrit. Kjo ka mundësuar krijimin e një tregu të përbashkët energjetik, pasi karakteristikat e shteteve kanë mundësuar përshtatshmëri më të madhe me njëri tjetrin. Gjenerimi i energjisë nga këto burime ka

mundësuar treg kompatibil me kërkesën e konsumatorit.

Tregu nordik i energjisë elektrike përbëhet tregu i ditës përpara, tregu brenda ditës dhe tregu i balancimit.³² Në vendet nordike, pjesa më e madhe e tregtisë bëhet në tregun e ditës përpara (Day Ahead), dhe "çmimi i sistemit", i cili është çmimi i përbashkët nordik për të gjitha orët e periudhës tjetër 24-orëshe dhe është thelbësore për formimin e çmimeve brenda kornizave tjera kohore.³³ Tregu brenda ditës është kryesisht një treg korrigjimi, ku akterët kanë mundësinë të tregtojnë në ekuilibër, përfshirë rregullimin e çdo tregtimi të mëparshëm nëse parashikimet rezultojnë të gabuara. Tregu brenda ditës mbyllet një orë para orës së dorëzimit. Tregu i balancimit është tregtimi i rezervave automatike dhe manuale të përdorura nga operatorët e sistemit të transmetimit nordik në mënyrë që të ruhet ekuilibri i energjisë gjatë orës së funksionimit. Këto lloje tregtimesh bëhen nga kompanitë përkatëse dhe operatorët e sistemeve transmetuese.

Nord Pool Spot³⁴ drejton tregun kryesor të energjisë në Evropë dhe u ofron klientëve tregtim një ditë përpara dhe brenda ditës. Tregu i një dite përpara është arena kryesore për tregtinë e energjisë dhe tregu brenda ditës plotëson tregun e një dite përpara dhe ndihmon në sigurimin e ekuilibrit midis ofertës dhe kërkesës. Konsumi i përgjithshëm i energjisë elektrike në vendet nordike është

³¹ Explanatory document to Energinet, Fingrid, Statnett and Svenska kraftnat, (2017) , ENTSO-e, e qasshme në www.shorturl.at/yFZ67 (qasur në prill, 2021)

³² Nordic Market Regulators, (2019), An Overview of the Nordic Energy market, e qasshme në www.shorturl.at/zFNST, (qasur në prill,2021)

³³ Ibid.

³⁴ Nord Pool Spot, e qasshme në <https://www.nordpoolgroup.com/> , (qasur në prill,2021)

rreth 390 TWh në vit, duke reflektuar ndërkombëtarisht shumë të lartë të konsumit të energjisë për person.³⁵ Këto modele të tregtimit kanë pasur benefite të mëdha për konsumatorët, pasi që mundësia e njoftimit me çmimet një ditë përpara ose gjatë ditës kanë shtyer që ata të kursejnë energji dhe njëkohësisht të ndihmojnë balancimin e tregut.

Ndërsa OST-të (Svenska kraftnät, Statnett, Fingrid dhe Energinet) janë përgjegjëse për tregun e balancimit. OST-të Nordike synojnë të krijojnë tregjet e kapacitetit rajonal të balancimit për balancimin e aFRR³⁶ dhe mFRR³⁷. Qëllimi i tregut të kapaciteteve aFRR është të sigurojë disponueshmërinë e rezervave të aFRR në përputhje me rregullat e dimensionimit të bllokut LFC dhe në këtë mënyrë të ofrojë siguri operationale.³⁸ Një tipar kryesor është se çmimet e transmetimit janë të pavarura nga distanca gjeografike midis palëve tregtare. Meqenëse nuk ka tarifa kufitare midis vendeve nordike, kufizimet fizike të kapacitetit ndër-lidhës janë barrierat e vetme të mbetura për të tregtuar përtej kufijve kombëtarë. Qëllimi i krijimit të një tregu të përbashkët nordik për kapacitetin aFRR është rritja e mirëqenies socio-ekonomike në një nivel më të lartë dhe për të rritur sigurinë operationale në mënyrën më efektive.

Ekzistojnë katër faktorë kryesorë prapa reformës relativisht të suksesshme të tregut të energjisë elektrike në vendet nordike.³⁹ Ato janë:

- Një dizajn i thjeshtë, por i shëndoshë i tregut, në një masë të madhe i mundësuar nga pjesa e madhe e energjisë hidrike.
- Hollimi i suksesshëm i fuqisë së tregut, i arritur nga integrimi i katër tregjeve kombëtare në një treg të vetëm nordik.
- Mbështetje e fortë politike për sistemin e furnizimit me energji elektrike të bazuar në treg.
- Angazhimi vullnetar, joformal ndaj shërbimit publik nga industria e energjisë.

Përdorimi i burimeve të ripërtrishme, ka treguar sukses në funksionimin dhe mbarëvajtjen e tregut nordik. Shtetet tjera nuk e kanë ndjekur shembullin e tillë, ani pse integrimi i tregjeve energjetike është politik zyrtarë e Bashkimit Europian.

Përfundime

Bashkimi i tregjeve të energjisë është i dobishëm edhe për rritjen e efikasitetit të rrjetit, rritjen e sigurisë së furnizimit dhe uljen e nevojës për prodhim. Të gjithë këto komponente avansohen me arritjen e bashkimit në fushën energjetike mes Kosovës dhe Shqipërisë. Ndër të tjera, komponentet e tilla krijojnë një treg kompatibil dhe me standarde shumë më të larta, standarde të cilat përafrohen me ato europiane. E sa i përket uljes së nevojës për prodhim, Kosova mund të zvogëlojë nivelin e prodhimit të energjisë elektrike përmes linjitet, ku rrjedhimisht rritet hapësira për integrimin e burimeve të ripërtrishme, e gjithashtu ulen nivelin e ndotjes së ajrit. Por këto nuk janë përparësitë e vetme të këtij procesi.

Bashkimi energjetik Kosovë-Shqipëri ulë kostot e operimit dhe rritë mundësitë për investime në burimet e ripërtrishme të energjisë. Në një treg të përbashkët, mundësitë e manovrimit në operim

³⁵ Why has the Nordic Electricity Market worked so well?, (2006) EIRIK S. AMUNDSEN and LARS BERGMAN, www.shorturl.at/gtE13, (qasur në prill, 2021)

³⁶ aFRR = automatic frequency restoration reserve

³⁷ mFRR = manual frequency restoration reserve

³⁸ Explanatory document to Energinet, Fingrid, Statnett and Svenska kraftnät www.shorturl.at/qvEHHK, (qasur në prill, 2021)

³⁹ Ibid.

janë më të lehta, për arsye se krijohet llojllojshmëri e gjenerimeve nga burime të ndryshme energjetike. E gjithë kjo ndikon në uljen e kostove operuese dhe hap rrugë për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet miqësore me ambientin. Këto burime, të cilat tashmë inkurajohen dhe avansohen nga pakot më të reja të energjisë kudo në botë, kanë potencial të madh edhe në tregun e synuar mes Kosovës dhe Shqipërisë. Burimet e ripërtrishme janë e ardhmja e sektorit energjetik, dhe shfrytëzimi i tyre është i domosdoshëm për të dyja vendet.

Ndonëse baza ligjore është e favorshme për të dy vendet individualisht, planifikimi strategjik është i ndryshëm dhe jo-koherent. Kjo bazë ligjore, e cila përkrah një bashkim të tillë, mund të jetë e mjaftueshme për arritjen e funksionalizimit të tregut, por jo për arritjen e objektivave të cilat do të sjellnin benefite shumë të mëdha për të dyja vendet. Andaj, është e domosdoshme përafrimi i objektivave mes ekspertëve të të dyja vendeve për të qartësuar udhën e cila i pret pas startimit të tregut.

Njohja e KOSTT si zonë e pavarur energjetike ka krijuar mundësi të reja për bashkëpunim ndërkufitar, përfshirë bashkimin energjetik. Vështirësitë që vendi ynë, e në veçanti operatori i transmissioinit KOSTT, kanë kaluar sa ishin pjesë energjetike e territorit të Serbisë, tashmë janë tejkaluar. Një pavarësim i tillë, përpos aspektit financiar, ka sjellur benefite dhe mundësi të shumta sa i përket objektivave energjetike të së ardhmes. Mundësitë e bashkëpunimit me vendet rajonale, kontrolli i rrjedhave të energjisë, zhvillimi i infrastrukturave të reja, janë shumë më lehtë të realizueshme tashmë. Kjo njohje ka mundësuar që Kosova të shtjellojë mundësinë e realizimit të një tregu të përbashkët energjetik me Shqipërinë, ku thelbi i këtij tregu do të jetë bursa shqiptare e energjisë, e njohur si ALPEX.

Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për realizimin e bursës shqiptare të energjisë. Shumë procese tashmë kanë përfunduar në koordinim të ndërsjellë mes palëve përfaqësuese nga të dyja vendet. Nëse edhe pjesa e mbetur e procesit shkon siç duhet, kjo bursë planifikon të fillojë operimin në marsin e vitit pasues, pra 2022, me bazë në Tiranë. Përpos krijimit dhe operimit për të dyja vendet fqinje, bursa parasheh zgjerimin e saj dhe bashkimin edhe me bursat tjera rajonale. Kjo do të sjellte zgjerimin e tregut dhe do të mundësonte fleksibilitet shumë më të madh për të gjitha vendet pjesëmarrëse.

Përfitimi i parë nga bashkimi energjetik është tek ulja e nevojës për prodhim të energjisë nga burime ndotëse. Kjo pasi që Shqipëria ka thuar se 100% gjenerim të energjisë nga burimet e ripërtrishme të energjisë. Madje kjo do të ndikojë pozitivisht edhe tek Kosova, pasi që do të hapen mundësi të reja të investimit në burimet e ripërtrishme. Vendi ynë ka potencial të madh të gjenerimit të energjisë nga burimet miqësore me ambientin, e një gjë e tillë nuk duhet të anashkalohet, pasi që e ardhmja e sektorit janë këto burime. Shembuj të funksionimit të tregjeve përmes këtyre burimeve ka në gjithë botën, e një ndër këto tregje është ai i vendeve skandinave të Europës.

Tregu nordik i energjisë është shembull i suksesshëm i bashkëpunimit rajonal. Ky treg, i cili në qendër të funksionimit ka burimet e ripërtrishme të energjisë, është shembulli më i mirë se si arrihet bashkëpunimi ndër-kufitar mes shteteve dhe storie suksesi e modeleve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Ky treg ka arritur siguri energjetike për konsumatorët e saj, duke shfrytëzuar burimet të cilat nuk e ndotin ambientin. Madje prodhimi shumicën e vitit është më i madh se sa që është kërkesa. Një shembull i tillë duhet të jetë inspirim për tregun e përbashkët Kosovë-Shqipëri, por jo vetëm, pasi që ndalesa kryesore nuk është vetëm bashkimi mes dyja vendeve, por është bashkimi rajonal.

Rekomandime

1. Kosova dhe Shqipëria të intensifikojnë procesin e bashkimit energjetik përmes angazhimit në nisma rajonale, koordinimit me ENTSO-e dhe bashkëpunimit në nivel bilateral. Bashkimi energjetik Kosovë-Shqipëri duhet të jetë temë e takimeve të ardhshme të dy qeverive për çka duhet të ndërtohen afate, të angazhohen institucione të përbashkëta dhe të alokohen kosto përkatëse. Procesi i bashkimit energjetik kombëtar duhet të shpallet prioritet në të dy anët e kufirit.
2. Kosova dhe Shqipëria të angazhohen për hartimin e një strategjie të përbashkët të energjisë. Hartimi i Strategjisë së përbashkët do t'u lejonte të dy shteteve të ndërtojnë modele të realizimit të kërkesës dhe realizimit të investimeve të përbashkëta, në atë mënyrë që të rritet eficientia dhe të lehtësohet planifikimi i investimeve. Strategjia e përbashkët që doli edhe si rekomandim në bazë të intervistave të realizuara për këtë punim, do të maksimizonte potencialin planifikues të politikave në të dy anët e kufirit dhe do të krijonte sinerji të bashkëpunimit për të përmbushur objektiva si dekarbonizimi dhe tranzicioni i energjisë.
3. Kosova dhe Shqipëria të përgatisin një strategji të përbashkët energjetike. Strategjia e përbashkët e energjisë është në të mirë të planifikimeve të përbashkëta të tregut dhe rajonit të përbashkët gjeografik. Për më tepër, një bashkim i tillë i kontribuon edhe planifikimeve për vijim të integritetit të tregut me rajonin. Sa më i madh tregu, përfitimet, siguria si dhe fleksibiliteti rriten. Andaj, bashkimi mes dyja vendeve nuk duhet të paraqet synimin e vetëm, por duhet të jetë fillimi i një procesi të domosdoshëm të lidhjes së rajonit me tregun evropian.
4. KOSTT, në bashkëpunim me OST të bashkërendoj aktivitetet me ENTSO-e ashtu që të shikohen mundësitë e investimeve në kapacitetet kufitare me shtetet e tjera. Kjo në funksion të zhvillimit të infrastrukturës dhe rritjes së shkëmbimeve të strukturës së re të përbashkët Kosovë-Shqipëri me vendet e rajonit. Investimet kapitale duhet të fokusohen në kufinj të ku shkëmbimet janë më të vogla dhe ku potenciali i zhvillimit të zonës energjetike është më i madh.
5. Të rriten kapacitetet e stafit në nivelin e dy operatorëve të transmissioinit përmes trajnimeve, vizitave studimore dhe investimeve në përmirësimin e kushteve të punës. Ndonëse profesionalizmi i punonjësve të dy operatorëve është i lartë, tregjet e përbashkëta dhe integriteti i tregut janë ndërmarrje të reja, për të cilat përvoja kryesisht mungon. Në këtë aspekt, një program i përbashkët trajnimi dhe aftësimi i punonjësve të të dy palëve është i nevojshëm.
6. Bursa kombëtare e energjisë të funksionalizohet pa vonesa të mëtejme. Ajo duhet të ofroj të dhëna në kohë reale dhe të respektohen standardet e transparencës dhe barazisë së pjesëmarrësve në bursë. Qasja në të dhëna duhet të jetë po ashtu e lehtë dhe të shfrytëzohet në maksimum përparësitë e teknologjisë informative për të parashikuar kërkesën, zhvilluar modele të kapaciteteve që nevojiten dhe për të rritur kujdesin ndaj konsumatorëve.
7. Kosova të përfundoj procesin e liberalizimit të tregut të energjisë dhe të sigurohet hapja e plotë e tregut në mënyrë që të rritet konkurrenca në bursën e energjisë. Ky proces duhet të shoqërohet me investime në eficientë e energjisë dhe në përkrahje për sektorin privat, i cili në planin afatshkurtë mund të përballlet me çmime më të larta. Liberalizimi i tregut është parakusht për funksionimin e konkurrencës në shkëmbimet e energjisë në tregun e përbashkët Kosovë-Shqipëri dhe në tregun rajonal kurdo kur një i tillë të funksionalizohet.
8. Kosova dhe Shqipëria të marrin shembull nga tregu nordik për të rritur transparencën, avancuar konkurrencën dhe për të rritur kapacitetet menaxhuese. Modeli i tregut nordik të energjisë është një ndër modelet ku bashkimi ka sjellë rritje të konkurrencës, ulje të nevojës për prodhim dhe rritje

të sigurisë së furnizimit. Me modelin e tregut nordik, do të mund të përfitonim nga përvoja duke rritur krahas kësaj edhe transparencën dhe shkëmbimin e të dhënave në përgjithësi.